



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 13

Prishtinë, më 4.7.2011, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

**PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Rasim Demiri, Afërdita Berisha-Shaqiri, Sevdije Lama, Nijazi Idrizi, Etem Arifi, Salih Morina dhe Liburn Aliu.

Mungoi : Daut Haradinaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtarë, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar, përfaqësues, media dhe Arsim Avdijaj, Hajzer Bublaku, Skender Sina, Përparim Ahmeti.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës ;**
2. **Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 23.6.2011;**
3. **Shqyrtimi i projektligjit për Kadastër,**
4. **Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime me këto sqarime shtesë nga kryetari.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23.6.2011 nr.12

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur 23.6.2011.

3. Shqyrtimi i projektligjit për Kadastër

Kryetari Nait Hasani njoftoi se shqyrtimi i projektligjit për Kadastër është duke u shqyrtuar më tepër sesa është parapa në Komision dhe grupin punues, mirëpo kjo ndodhë gjithnjë duke pasur parasysh harmonizimin e qëndrimeve dhe dilemave. Gjithashtu edhe **Liburn Aliu** si kryesues i

GP tha se në takimet e deritanishme të cilat kanë qenë mjaft të ngjeshura grupi punues është munduar të harmonizoi qëndrimet ngase dy ekspertë (**Arsim Avdijaj** dhe **Përparim Ahmeti**) të angazhuar kanë konstatuar se kemi të bëjmë me një projektligj i cili ka të meta, mirëpo për shkak të donacioneve të premtuara nga Banka Botërore dhe për shkak të faktit se pas dy vitesh do të nxjerrët një ligj unik për regjistrin e pronave dhe Kadastrin, është vepruar në atë drejtim që ky komision të kompletoj këtë projekt aq sa është e mundur dhe ta dërgoj në leximin e dytë.

Në vazhdim disa anëtarë të komisionit (**Salih Morina, Afërdita Berisha dhe Sevdije Lama**) kërkuar sqarim më të hollësishëm pse është ashtu, pasi që ka mundur ky komision ta kthej projektin Qeverisë qysh në leximin e parë, mirëpo sqarimi i mëtejshëm i kryesuesit të GP ishte se GP ka konstatuar nuk ka kthim prapa për shkak të shkaqeve të lartcekura. **Nait Hasani** sugjeroi të filloj shqyrtimi përfundimtar nen për nen.

Neni i parë i projektligjit u tha se duhet të riformulohet por mundësisht pa u prekur thellësisht përmbajtja, ngase në atë mënyrë do të ndryshoj kahja të cilin ka dashur Qeveria të hartoj. Në vazhdim pasoi puna e komisionit duke shqyrtuar projektligjin nen për nen, ndërsa në fund përfundoi me riformulimin e nenit 29 të cilin riformulim e ka miratuar GP në takimin e fundit. Komisioni nxori këtë :

P Ë R F U N D I M

Deri në mbledhjen e rregullt të komisionit më 11 korrik 2011, kur do të procedohet ky projektligj tek komisionet kryesore, ekspertët Arsim Avdijaj dhe Përparim Ahmeti të sjellin në komision amendamentet për të cilat komisioni u pajtua në mbledhjen e sotme, në bashkëpunim me stafin e komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 15,00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani